

POLITIKA E PRIVATËSISË



European Quality & Safety Control

Certification Body

➤ Hyrje

European Quality and Safety Control (EQSC) shpk është e ndërgjegjshme dhe e përgjegjshme për rëndësinë e mbrojtjes së të dhënave personale. Angazhimin e saj për mbrojtjen e të dhënave personale e shpreh nëpërmjet kësaj Politike Privatësisë.

Politika është botuar në faqen e internetit <https://eqsc-cert.org> dhe përfshin rregullat tona në lidhje me mbledhjen, përdorimin dhe dhënien e të dhënave personale që marrim nga ushtrimi i aktivitetit dhe nga përdoruesit e faqes sonë të internetit. Duke vazhduar të përdorni faqen tonë të internetit, ju pranoni mbledhjen dhe përdorimin e të në përputhje me këtë politikë.

➤ Kush është European Quality and Safety Control (EQSC) shpk?

European Quality and Safety Control (EQSC) shpk (referuar shkurtimisht si "EQSC") është një trupë certifikuese kompetente në fushën e vlerësimit të konformitetit. EQSC operon përmes stafit të saj profesional në disa sektorë të biznesit privat dhe publik.

EQSC si një organ i Akredituar kontrolli, kombinon njohuritë teknike dhe ekspertizën me paanshmërinë, për të ofruar sigurinë në treg që klientët e certifikuar nga EQSC funksionojnë sipas standardeve përkatëse, përkundëjt të cilave janë certifikuar. Shërbimi i Trajnimit i ofruar nga ne u siguron profesionistëve besimin se ata do të përfitojnë më së miri mbi çështje që lidhen me pajtueshmërinë me standardet dhe ligjet në fuqi, si dhe përvojën praktike.

➤ Kush është përgjegjës për përpunimin e të dhënave dhe me kë mund të kontaktoni?

European Quality and Safety Control (EQSC) shpk
Grupë Certifikuese

Rr: Sulejman Pasha, Pallati 70/1, Kati 1, Nr.1,

1016 Tiranë - Shqipëri

Telefon: +35542227674

Cel: +355696087402

Email: info@eqsc-cert.org

Web: www.eqsc-cert.org

➤ Cilat burime dhe të dhëna përdorim?

Kur ofrojmë shërbimet tona në fushat e certifikimit dhe auditimit të sistemeve të menaxhimit, certifikimit të produkteve, si dhe certifikimit dhe trajnimit të individëve, ne përpunojmë të dhëna personale që klienti (pala që porositi shërbimet e EQSC, përfshirë personin e tij të kontaktit, ose një person që merr pjesë në një shërbim të EQSC) na vë në dispozicion po aq sa të dhënat që ne i fitojmë vetë kur ofrojmë shërbimet e EQSC (p.sh. gjatë një auditimi ose një provimi). Si rregull, EQSC nuk mund të sigurojë shërbimet e dëshiruara pa këto të dhëna.

Të dhënat personale përkatëse përfshijnë detaje (p.sh. emrin, adresën dhe të dhënat e tjera të kontaktit, datën dhe vendin e lindjes), të dhënat e kontratës (p.sh. dokumentacioni i auditimit, dokumentacioni i ngjarjeve, të dhënat rreth Certifikatave, të dhënat e kontabilitetit, të dhënat bankare).

➤ Për çfarë arsyeje i përpunojmë të dhënat tuaja dhe mbi çfarë baze ligjore? Të dhënat personale që ne mbledhim gjatë ofrimit të shërbimeve të EQSC do të përpunohen për qëllime të kryerjes së kontratave, sipas kushteve përkatëse, si dhe për dokumentacionin e kërkuar, në përputhje me kërkesat normative (të tilla si ISO/IEC 17021, ISO/IEC 17024, ISO/IEC 17065 dhe kërkesat e mundshme shtesë nga modelet që do të auditohen me porosi të klientit), për mbajtjen e kontabiliteti, për krijimin dhe mbrojtjen e kërkesave ligjore, si dhe për menaxhimin e marrëdhënieve me klientët, duke përfshirë hartimin e ofertave për shërbime të mëtejshme të EQSC (p.sh. ri-certifikime dhe certifikime shtesë ose trajnime përkatëse).

Informacioni/të dhënat personal që ne marrim në rastet kur përdorni faqen tonë të internetit, përpunohet për qëllime të ofrimit të shërbimeve të kërkuara nga ju ose për qëllimet tona të reklamimit dhe marketingut, në mënyrë që t'ju dërgojmë informacione dhe reklama për shërbimet dhe produktet, lajmet dhe informacione të tjera që mund të jenë interesante për ju, për aq sa nuk keni kundërshtuar për këto hapa të përpunimit. Faqja jonë e internetit mund të përmbajë lidhje ose t'ju ridrejtojë

tek faqe të tjera interneti. EQSC nuk është përgjegjës për përmbajtjen dhe hapat e përpunimit të këtyre faqeve, dhe ju rekomandon të lexoni deklaratën / politikat përkatëse për privatësinë të këtyre faqeve.

Baza ligjore për përpunimin e informacionit/të dhënave personale është Legjislacioni Shqiptar, relevant për Ligjin Nr. 9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" (i ndryshuar).

Pëlqimi për përdorimin e të dhënave personale që është dhënë mund të revokohet, përditësohet ose ndryshohet në çdo kohë me kërkesë me shkrim të kontaktet e mësipërme të dhëna në pjesën "Kush është përgjegjës për përpunimin e të dhënave, dhe me kë mund të kontaktoni?" më lart.

➔ Kush mund ti aksesojë të dhënat e mia?

Brenda EQSC, të gjitha departamentet përkatëse dhe personeli që kanë nevojë për të dhënat tuaja për përmbushjen e detyrimeve kontraktuale dhe ligjore ose për përpunim për shkak të interesit të ligjshëm, do t'u jepet qasje në të dhënat tuaja. Për qëllim të ofrimit të shërbimit EQSC të dëshiruar nga klienti, EQSC do t'i kalojë të dhënat auditorëve, trajnerëve, vlerësuesve dhe ekspertëve teknikë të jashtëm të EQSC që veprojnë nën marrëveshjet kontraktuale me EQSC. Për më tepër, EQSC shfrytëzon shërbimet e ofruara nga ofruesit e jashtëm të IT.

Sipas rregullave të akreditimit dhe Standardeve përkatëse (në veçanti ISO/IEC 17021, ISO/IEC 17024, ISO/IEC 17065), EQSC është e detyruar të sigurojë informacion të arritshëm publikisht për certifikatat e lëshuara.

Ky informacion mund të jetë i arritshëm në faqen e internetit të EQSC ose të sigurohet me kërkesë me shkrim, dhe përmban të paktën emrin e kompanisë / individit që mban certifikatën, adresat, vlefshmërinë e certifikatës, numrin e certifikatës, qëllimin gjeografik të certifikimit, dhe dokumentet normative.

Bazuar në kërkesat normative, EQSC do të jetë më tej i detyruar të sigurojë informacione/të dhëna personale mbi shërbimet e tij, të Organet e Akreditimit dhe/ose Trupat e Certifikimit dhe / ose t'u lejojë këtyre organeve qasje mbi informacionin, sipas procedurave

të akreditimit ose pas kërkesës së tyre me shkrim. Për më tepër, EQSC mund të transmetojë të dhëna personale tek marrës të tjerë (p.sh. autoritete publike) në mënyrë që të përmbushë detyrimet ligjore për raportim.

➔ Sa kohë do të ruhen të dhënat e mia?

Të dhënat do të ruhen për periudhën në të cilën kjo është e nevojshme për t'i mundësuar EQSC të përmbushë detyrimet e saj kontraktuale dhe ligjore. Të dhënat në lidhje me klientin (përfshirë organet që kanë fuqi të përgjithshme të përfaqësimit dhe personave të kontaktit pranë klientit), si dhe historiku i shërbimeve të ofruara arkivohen deri në fund të marrëdhënies së biznesit dhe, përtej kësaj, deri në skadimin e periudhave të garancisë, periudhave të kufizimit dhe periudhave të përcaktuara me ligj për ruajtjen. Dokumentet e aplikimit, raportet e auditimit dhe verifikimit, si dhe dokumentet e tjera që lidhen me certifikimin, në thelb do të ruhen për 3 vjet për aq sa kërkesat normative ose ligjore nuk kërkojnë një periudhë më të gjatë ruajtjeje.

➔ Në çfarë mase merren vendimet në mënyrë të automatizuar?

Në asnjë lloj mënyre!

➔ A bëhet profilizimi?

Në mënyrë që të jemi në gjendje të informojmë dhe këshillojmë në mënyrë specifike për sa i përket produkteve, ne përdorim mjete vlerësimi. Këto mjete mundësojnë komunikim dhe reklamim të orientuar nga nevoja, përfshirë studimin e tregut dhe marrjen e opinionëve. Ju mund të kundërshtoni profilizimin e përdorur për reklamim të drejtpërdrejtë, në çdo kohë.

➔ A analizohet sjellja e përdoruesit në faqen e internetit?

Kjo faqe interneti përdor shërbimin "Google Analytics", i cili ofrohet nga Google Inc., për të analizuar mënyrën se si përdoruesit përdorin internetin. Shërbimi përdor "cookie", d.m.th. skedarë

teksti të ruajtur në pajisjen tuaj fundore. Si rregull, informacionet/të dhënat e mbledhura nga cookies do të dërgohen në një Server Google në SHBA dhe ruhen atje.

Ju keni mundësinë për të parandaluar ruajtjen e cookies në pajisjen tuaj duke konfiguruar në mënyrë adekuate cilësimet e shfletuesit tuaj. Nuk është e garantuar që ju të mund të përdorni të gjitha funksionet e kësaj faqe interneti pa kufizime nëse shfletuesi juaj nuk pranon asnjë cookie.

Për më tepër, mund të përdorni një shtojcë të shfletuesit për të parandaluar dërgimin e informacionit të mbledhur nga cookies (përfshirë adresën tuaj IP) në Google Inc. dhe të përdoret nga Google Inc.

Këtu mund të gjeni informacione shtesë mbi përdorimin e të dhënave nga Google Inc.:

<https://support.google.com/analytics/answer/6004245?hl=en>

➔ Cookies

Faqja jonë e internetit përdor cookies. Cookies janë skedarë të vegjël teksti që do të ruhen në diskun tuaj në vizitat e faqes sonë të internetit. Në këtë drejtim, mund të bëhet një dallim midis llojeve të mëposhtme të cookies:

- "Cookies të Sesioneve", e cila, në varësi të përcaktimit të programit të shfletuesit tuaj, do të fshihet automatikisht përsëri kur të mbarojnë operacionet e shfletuesit
- "Cookies të Përherëshëm", të cilave u sigurohet një periudhë skadimi dhe do të vazhdojnë kur mbarojnë operacionet e shfletuesit

Për të parandaluar aludimin në përdorimin e cookies pasi të jetë shtypur OK në secilën vizitë të faqes në internet, një "Cookie i Përherëshëm", "cb-enabled", do të ruhet për periudhën 365 ditë.

Në faqen tonë të internetit, ne gjithashtu përdorim të ashtuquajturat "Cookies të Sesioneve" në mënyrë që t'ju lehtësojmë përdorimin e faqeve të internetit dhe garantimin e funksioneve themelore të faqeve të internetit.

Këto cookie nuk tërheqin asnjë informacion në lidhje me ju që ruhet në diskun tuaj dhe nuk do të dëmtojnë PC tuaj ose skedarët tuaj. Shumica e shfletuesve janë caktuar të pranojnë cookie automatikisht. Sidoqoftë, mund të çaktivizoni ruajtjen e cookies ose përcaktoni te shfletuesi juaj që t'ju njoftojë kur cookies.

Ju mund të fshini cookies që tashmë janë në kompjuterin tuaj, në çdo kohë. Mënyra për ta bërë këtë varet nga shfletuesi. Ju lutemi shikoni udhëzimet për shfletuesin tuaj (te "Ndihma" në menunë e shfletuesit).